

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga  
Gjyqtari i EULEX-it Bertil Ahnborg si kryetar i kolegjit,  
Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Nazmije Ibrahimimi dhe  
Gjyqtari i Gjykatës Supreme Shukri Sylejmani si anëtarë të kolegjit,  
në praninë e zyrtarit ligjor të EULEX-it Holger Engelmann, si procesmbajtës,

në lëndën penale kundër të pandehurit

02 emri i të atit ( )  
r ( ) me shtetësi të Kosovës, adresa e fundit e  
banimit, ( ) , biznesmen, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, ka  
në paraburgim në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, në paraburgim që prej  
datës 19 prill 2007,

**I dënuar në shkallën e parë** me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P nr. 155/2007, të datës 17 prill 2008, si gjykatë e shkallës së parë, i shpallur fajtor për veprat penale **Vrasje e Rëndë** në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 5 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) lidhur me nenin 23 të KPPK-së, **Vrasje e Rëndë në Tentativë** në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 11 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së, **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 1 të KPPK-së, dhe për një pikë tjetër të veprës penale **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së, dhe i dënuar me një dënim unik afatgjatë me njëzet e pesë (25) vjet burgim,

**I dënuar në shkallën e dytë** me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP.-KŽ. Nr. 110/2011, të datës 6 nëntor 2012, me të cilin është ndryshuar aktgjykimi i mëparshëm i Gjykatës Supreme të Kosovës AP.-KŽ. Nr. 481/2008, i datës 21 korrik 2009, ku pas ankesave Gjykata Supreme e Kosovës në shkallë të tretë me aktvendimin API.-KŽI. Nr. 9/2009, të datës 28 dhjetor 2010, ka kthyer lëndën në gjykatën e shkallës së dytë për rigjykim, për veprën penale **Vrasje** në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 146 të KPPK-së lidhur me nenin 12 paragrafin 2 dhe nenin 23 të KPPK-së (pika 1 e aktakuzës) dhe për veprën penale **Vrasje në tentativë** në bashkëkryerje, të dyja të kryera në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor, në kundërshtim të nenit 146 lidhur me nenin 20, nenin 23 dhe nenin 12 paragrafin 2

të KPPK-së (pika 2 e aktakuzës), të dënueshme sipas nenit 147 paragrafit 1 pikës 11 të KPPK-së dhe për një pikë të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve in në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së, dhe i dënuar me një dënim unik me njëzet e pesë (15) vjet burgim,

Duke vendosur në lidhje me ankesën e paraqitur më 14 shkurt 2013 nga Prokurori i Shtetit të Kosovës, ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës *EOR* më 25 shkurt 2013 dhe mbi 'Përgjigjen në ankesë' të paraqitur nga avokatët mbrojtës *LS* dhe *B-1* në emër të pandehurit *OZ* kundër aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP.-KŽ. Nr. 110/2011, të datës 6 nëntor 2013.

Pas seancës publike të mbajtur më 4 shtator 2013, në prani të të pandehurit *OZ*, të avokatëve mbrojtës Ethem Rogova dhe Bejtush Isufi, të prokurorit të EULEX-it Claudio Pala, që përfaqëson ZPSHK-në, pas këshillimit dhe votimit në lidhje lidhur me ankesat e sipërpërmendura, kolegji merr këtë

## AKTGJYKIM

Ankesat e paraqitura nga avokatët mbrojtës në emër të pandehurit *OZ* dhe ankesa e paraqitur nga Prokuroria, PRANOHEN PJESËRISHT. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, AP.-KŽ. Nr. 110/2011, i datës 6 nëntor 2012, NDRYSHOHET si në vijim:

**I pandehuri shpallet fajtor për:**

Sipas pikës 1 të aktakuzës, veprën penale Vrasje të kryer në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor sipas nenit 146 në lidhje me nenet 23 dhe 12 paragrafin 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së),

Sipas pikës 2 të aktakuzës, veprën penale Vrasje në tentativë të kryer në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor sipas nenit 146 në lidhje me nenet 20, 23 dhe 12 paragrafin 2 të KPK-së dhe

Sipas pikave 2 dhe 3 të aktakuzës, dy (2) pika të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nenit 374 paragrafit 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së në fuqi që nga data 1 janar 2013), të kryera më 10 tetor 2005 dhe 19 prill 2007.

Sipas nenit 71 paragrafit 1 të KPK-së, shpallen dënimet në vijim:

Sipas pikës 1 të aktakuzës, dënimi me tetë (8) vite burgim për veprën penale Vrasje të kryer në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor sipas nenit 146 në lidhje me nenet 23 dhe 12 paragrafin 2 të KPK-së,

Sipas pikës 2 të aktakuzës, dënimi me katër (4) vite burgim për veprën penale Vrasje në tentativë të kryer në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor sipas nenit 146 në lidhje me nenet 20, 23 dhe 12 paragrafin 2 të KPK-së,

Sipas pikës 3 të aktakuzës, dënimi me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nenit 374 paragrafit 1 të KPRK-së të kryer më 10 tetor 2005, dhe

Sipas pikës 4 të aktakuzës, dënimi me gjashtë (6) muaj burgim për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nenit 374 paragrafit 1 të KPRK-së të kryer më 19 prill 2007.

Duke rezultuar me një dënim unik me dymbëdhjetë (12) vjet burgim.

Koha e kaluar në paraburgim prej 19 prillit 2007 është llogaritur në dënimin e shqiptuar.

Në lidhje me pjesët e mbetura, ankesat REFUZOHEN SI TË PABAZUARA.

## ARSYETIMI

### Procedura e deritanishme e lëndës

#### Historiku

Më 10 tetor 2005 rreth orës 16:20 në tregun e fshatit Xërxë, Komuna e Prizrenit, dy kryerësit duke vepruar në marrëveshje u afruan me armë dy personave Shqiptarë të Kosovës, **H.R.** dhe vëllait të tij **N.R.**. Ata kanë shtënë në **H.R.** dhe e kanë vrarë. Ata kanë shtënë edhe në **N.R.**, por pas rrjedhës së ngjarjes ai u plagos dhe më pas u trajtua në spital.

Më 16 korrik 2007, prokurori publik i qarkut të Prizrenit ka përgatitur aktakuzën PP nr. 230/ 2005, kundër të pandehurve **O.Z.** dhe një kryerësi të dytë të pretenduar, e cila u ngrit më 17 korrik 2005 në Gjykatën e Qarkut në Prizren. Të dy të pandehurit ishin akuzuar për veprat penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 147 paragrafin 5 dhe me nenin 23 të KPPK-së; të vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 147, paragrafin 11, lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së; dhe të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafin 1 të KPK-së, dhe vetëm i pandehuri **O.Z.** është akuzuar edhe për pikën e dytë të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafin 2 të KPPK-së.

Më 30 gusht 2007 aktakuza është konsoliduar me anë të vendimit për konfirmimin e aktakuzës përmes aktvendimit përkatës të Gjykatës së Qarkut në Prizren KA nr. 112/2007.

#### Gjykata e Qarkut

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar para Gjykatës së Qarkut të Prizrenit kundër **O.Z.** dhe njërit të bashkakuzuar është mbajtur në mes datës 31 janar dhe 17 prill 2008.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari **O.Z.** dhe i bashkakuzuari janë marrë në pyetje dhe një numër i dëshmitarëve kanë dhënë dëshmi.

Gjatë gjykimit stafi mjekësor janë konsultuar vazhdimisht për tu siguruar se i pandehuri **O.Z.** i cili vuan nga disa sëmundje fizike dhe psikologjike, do të jetë fizikisht dhe mendërisht në gjendje ta përcjellë procedurën.

Më 17 prill 2008 është shpallur aktgjykimi me të cilin dy të pandehurit shpallen fajtorë për veprat penale Vrasje e Rëndë në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 4, 5 dhe 8 të KPPK-së dhe për Vrasje e Rëndë në Tentativë në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 11, të dy veprat të kryera në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPPK-së, dhe për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 1 të KPPK-së, si dhe vetëm i pandehuri **O.Z.** shpallet fajtor për një pikë tjetër të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së, dhe secili i pandehur dënohet me dënim unik me nga njëzet e pesë (25) vjet burgim,

Gjykata Supreme e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë (herën e parë)

Të dy avokatët mbrojtës të të pandehurit **O.Z.** **E.R.** i Av **R.**  
**G.**, me kohë kanë paraqitur ankesë kundër aktgjykimi më 4 gusht 2008.

Më 29 tetor 2008, avokati mbrojtës **E.R.** ia ka dërguar gjykatës një letër të të pandehurit dhe ka kërkuar nga ta që t'ia bashkëngjisin ankesës. Në atë letër, **O.Z.** **Z.** deklaruar se pranon se kishte vrarë viktimën **H.R.** i dhe se e kishte plagosur vëllain e tij **N.R.** dhe se vetëm ai ishte përgjegjës.

Edhe avokati mbrojtës i të bashkëpandehurit të mëparshëm Av **H.R.**, me kohë ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimi të Gjykatës së Qarkut më 11 gusht 2008.

Më 1 dhjetor 2008, ZPSHK-ja e dha mendimin e vet në përputhje me nenin 409 paragrafin 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), duke propozuar që të refuzohen të gjitha ankesat si të pabazuara dhe jomeritore. Prokurori publik nuk ka paraqitur ankesë.

Më 21 korrik 2009, kolegji i apelit i Gjykatës Supreme të Kosovës kishte nxjerrë aktgjykimin AP.-KŽ.481 /2008, me të cilin kishte pranuar në mënyrë të pjesshme ankesën e parashtruar nga i pandehuri **O.Z.** sa i përket cilësimit juridik të pikave 1 dhe 2 të aktgjykimit të shkallës së parë, të cilësuar si një vrasje e rëndë, në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 11 të KPPK-së, dhe sa i përket cilësimit juridik të pikës 3 të aktgjykimit të shkallës së parë, ku thuhet se i pandehuri **O.Z.** ka kryer vetëm veprën penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafin 2 të KPPK-së. Ankesat janë refuzuar për pjesët e tjera dhe aktgjykimi i shkallës së parë është konfirmuar.

Gjykata e shkallës së dytë ka shfajësuar të bashkëpandehurin nga të gjitha akuzat në ë mungesë të provave.

Gjykata Supreme e Kosovës si gjykatë e shkallës së tretë

Tre avokatët mbrojtës të *O.Z.*, *E.R.*, *F.C.* dhe *T.G.* me kohë kanë paraqitur ankesë kundër aktgjykimi të kolegjit të apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të lëshuar në shkallë të dytë më 21 korrik 2008 (AP.-KŽ. No.481/2009).

Gjykata Supreme e Kosovës në shkallë të tretë, me aktvendimin API.-KŽI. Nr. 9/2009, të datës 28 dhjetor 2010, pranoi pjesërisht ankesat e tre avokatëve mbrojtës dhe e anuloi aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, AP.-KŽ. Nr. 481/2008, të datës 21 korrik 2009. Lënda u kthye për rigjykim në Gjykatën Supreme si gjykatë e shkallës së dytë. Pjesët e mbetura të ankesave u refuzuan.

Aktgjykimi u anulua për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, në përputhje me nenin 403 paragrafin 2 të KPPK-së, për shkak të shkeljeve të ligjit penal, në përputhje me nenin 404 pikën 2 të KPPK-së dhe po ashtu për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata e shkallës së dytë, nuk ka arritur në veçanti të përcaktojë se a ekzistojnë rrethana të cilat e pamundësojnë ose e kufizojnë përgjegjësinë penale.

Përveç kësaj, gjykata nuk ka vlerësuar e as nuk ka marrë parasysh dëshminë e të pandehurit të dhënë me shkrim para seancës ankimore dhe dëshminë e tij në seancë kur pranon se ai e kishte "vlarë" *H.R.* he plagosur vëllain e tij". Kolegji nuk ishte pajtuar me arsyetimin e gjykatës së shkallës së dytë që dëshmia të cilësohet thjesht si një lloj i pranimit të fajësisë, por në anën tjetër konsideroi se dëshmia e tillë duhet të merret parasysh si relevante, si e domosdoshme dhe në fakt si provë esenciale për vërtetimin e fajësisë së të akuzuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës si gjykatë e shkallës së tretë (herën e dytë)

Më 6 nëntor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë ka mbajtur shqyrtimin siç është udhëzuar me aktvendimin e mëparshëm të Gjykatës Supreme.

Sidoqoftë, tanimë më 14 nëntor 2011 kryetari i kolegjit duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe pas rekomandimeve të gjykatës së shkallës së tretë, ka nxjerrë urdhrin me të cilin duhet të kryej ekspertiza psikiatrike e *O.Z.* në Klinikën e Psikiatrisë së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Urdhri pastaj është ndryshuar më datën 12 mars 2012.

Komisioni i ekspertëve i cili ka kryer ekspertizën ka qenë i përbërë nga doktor *F.D.* (psikiatër) doktoresha Sh *S.H.V.* (psikiatër) dhe *S.H.V.* (psikologe)

klinike). Raporti i super ekspertizës së *O.Z.* është dorëzuar në shkrimoren e gjykatës më datën 6 shtator 2012 dhe u është komunikuar palëve.

Njëri nga anëtarët e këtij komisioni, doktori *F.D.* është ftuar në gjykatë për të dhënë sqarimet e mëtejshme lidhur me gjetjet e kësaj super ekspertize.

Kolegji ka konstatuar nga gjetjet se i pandehuri ka pasur kapacitet që të njohë kundërligjshmërinë e aktivitetit të tij kriminal dhe aftësi që të veproj në mënyrë përkatëse. Në anën tjetër, në mënyrë të qartë është paraqitur se për shkak të personalitetit të tij të çrregulluar dhe diagnozës së Çrregullimit nga Stresi Post Traumatik (ÇSPT), kapaciteti i tij që të abstenoj nga kryerja e veprave kriminale ka qenë e zvogëluar. Prandaj, kolegji ka përfunduar se në kohën kur i pandehuri ka kryer veprat penale vrasje dhe vrasje në tentativë ka qenë në gjendje të tillë emocionale sa që aftësia e tij për të kontrolluar veprimet e tij ka qenë seriozisht e dobësuar. Kjo sipas kolegjit do të shpinte në zvogëlim të konsiderueshëm të dënimit sipas nenit 12 paragrafit 2 dhe neneve 64 dhe 66 të KPPK-së.

Gjatë elaborimit të çështjes së *dashjes dhe paramendimit*, kolegji është i mendimit se megjithëse *O.Z.* ka vepruar në gjendje të aftësisë të zvogëluar mendor, nuk ka dyshim se ai me dashje ka shtënë në vëllezërit *R.* Kolegji ka gjetur se ai ishte plotësisht në dijeni të faktit se ai qëlloi dy persona me qëllim vrasjen e tyre, duke e ditur se të shtënat nga një distancë e shkurtë kanë probabilitet të lartë për të shkaktuar vdekjen e personave të sulmuar. Prandaj, kolegji ka gjetur se ai ka vepruar së paku me *dashje eventuale*. Së fundi, kolegji mendon se veprat penale të Vrasje dhe Vrasje në tentativë sipas Nenit 146 të KPPK-së nuk kërkojnë *paramendim*.

Si rezultat, me aktgjykimin AP.-KŽ. 110/2011, aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar. I pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale Vrasje të *H.R.* në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendorë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenin 23 dhe 12 paragrafin 2 të KPPK-së (pika 1 e aktakuzës), Vrasje në tentativë të *N.R.* në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendorë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenin 20, 23 dhe 12 paragrafin 2 të KPPK-së (pika 2 e aktakuzës) dhe një pikë të Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së (pika 4 e aktakuzës). Një pikë e Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafëve 1 dhe 2 të KPPK-së është përfshirë në pikat 1 dhe 2 të aktakuzës. Gjykata ka shpallur për pikat 1 dhe 2 sipas nenit 147 pikës 11 të KPPK-së një dënim të vetëm prej 14 viteve burgim dhe për pikë 4 të aktakuzës dënimin prej 2 viteve burgim, duke rezultuar në dënim unik prej

15 viteve burgim. Koha e të pandehurit e kaluar në paraburgim është llogaritur dhe kërkesa e tij për ndërprerjen e paraburgimit është refuzuar si e pabazuar.

## **Ankesat dhe argumentet e palëve**

### Ankesa e Prokurorisë

Më 14 shkurt 2013, ZPShK-ja ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit AP.-KŽ. 110/2011 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 6 nëntor 2012 mbi bazën e shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionet penale. ZPShK-ja në veçanti gjen se dënimi i vetëm i shqiptuar për veprat penale Vrasje dhe Vrasje në tentativë (pikat 1 dhe 2 të aktakuzës) në bazë të nenit 147 pikës 11 të KPPK-së shkel dispozitën e nenit 64 paragrafin 1 të KPPK-së. Neni i përmendur përcakton se “Gjykata e cakton dënimin për vepër penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë vepër penale ...”. Gjersa gjykata ka shpallur të pandehurin fajtor për vrasjen e I H.R. të kryer në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendorë sipas neneve 146, 23 dhe 12 paragrafit 2 të KPPK-së dhe vrasje në tentativë të N.O.R. të kryer në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendorë sipas neneve 146, 20, 23 dhe 12 paragrafit 2 të KPPK-së, neni 147 pika 11 e KPPK-së definon elementet dhe dënimin për vepër të ndryshme penale.

ZPShK-ja gjithashtu kundërshton gjetjet e gjykatës se “Vepra penale Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafëve 1 dhe 2 të KPPK-së (pika 3 e aktakuzës) është përfshirë në pikat 1 dhe 2. Sipas ZPShK-së, gjykata nuk ka qenë e autorizuar që në këtë aspekt të aplikojë as parimin e “konsumimit” me ose “përfshirje” në kuadër të veprave penale të pikave 1 dhe 2. Vrasja nuk përmban elementet e Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, e as rëndësia e veprës penale nuk është e parëndësishme në krahasim me vrasjen. Të dy veprat janë të drejtuara kundër vlerave të ndryshme shoqërore të mbrojtura. Vetë vepra penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve bart rrezik të konsiderueshëm për shoqërinë dhe duhet të dënohet ndaras.

Rrjedhimisht, gjykata është dashur të shpallë dënime të ndara për veprat penale sipas të gjitha kate pikave të aktakuzës dhe të shqiptoj një dënim unik në pajtim me nenin 71 të KPPK-së. Në lidhje me veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, gjykata do të duhej të aplikonte nenin 374 paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në fuqi prej 1 janarit 2013, si ligj më i favorshëm për të pandehurin.

ZPShK-ja propozon që të ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar në mënyrën e përmendur më lartë.



Ankesa e avokatit mbrojtës 1 E.R.

Më 25 shkurt 2013, av E.R. i emër të pandehurit ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ankesa bazohet në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe përfundimisht vendim të gabuar mbi sanksionet penale.

Ankesa kundërshton se dispozitivi është i pakuptueshëm dhe kundërtëhënës me vetveten pasi që vendimi mbi sanksionet penale bazohet në dispozita të ndryshme të ligjit penal nga dënimi mbi fajësimin. Pasi që gjykata ka gjetur se vepra penale nën pikën 1 të aktakuzës është kryer në gjendje të zvogëluar të kapacitetit mendorë është dashur që të dënoj të pandehurin për vrasje të kryer në gjendje të afektit mendorë sipas nenit 148 të KPPK-së. Në lidhje me veprën penale vrasje në tentativë, Gjykata Supreme gjatë shqyrtimit më 6 nëntor 2012 nuk ka ekzaminuar faktet në lidhje me akuzat e pikës 2 të aktakuzës. Në veçanti, gjykata nuk ka vërtetuar *mens rea*. Pa paramendim për të vrarë viktimën, vepra e tillë penale nuk mund të ekzistojë. Për më tepër, që veprimi i të pandehurit ka rezultuar vetëm në plagosjen e N.R. dhe madje edhe ajo ka ndodhur aksidentalisht dhe pa dashje. Gjykata nuk ka marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese relevante dhe si rrjedhojë ka shpallur një dënim të ashpër jo adekuat. Avokati mbrojtës propozon që i pandehuri të dënohet për veprat penale Vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor sipas nenit 148 të KPPK-së dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së, kurse të lirohet nga akuza për Vrasje në tentativë sipas nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPPK-së.

Përgjigja në ankesë e avokatit mbrojtës L.S.

Më 5 mars 2013, Avokati mbrojtës L.S. i emër të pandehurit ka paraqitur një dokument me titullin 'Përgjigje në ankesë' pranë Gjykatës Themelore në Prizren. Ai propozon pranimin e pjesshëm të ankesës së Prokurorit të Shtetit dhe ndryshimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Avokati mbrojtës mbështet pohimin e ZPShK-së për mos cilësimin e veprave sipas pikave 1 dhe 2 të aktakuzës si një por si dy vepra të ndara. Një element esencial i nenit 147 pikës 11 të KPK-së është duke munguar pasi që është kryer vetëm një vrasje. Prandaj dispozita nuk mund të zbatohet dhe duhet të shqiptohen sanksione penale të ndara. Vepra penale sipas pikës 2 duhet të cilësohet si Lëndim i rëndë trupor sipas nenit 154 të KPK-së pasi që i pandehuri nuk ka pasur motiv për të vrarë N.R. për veprën penale sipas pikës 1 të shqiptohet një dënim më i butë. Për pikat 3 dhe 4 dispozita më e favorshme e nenit 374 paragrafit 1 të KPRK-së duhet të zbatohet si dhe gjoba prej 1,000 Euro në vend të dënimit me burgim. Ai propozon që të

shpallen dënimet si në vazhdim: 10 vite për pikën 1, 2 vite për pikën 2 dhe gjobë prej 1,000 Euro për pikat 3 dhe 4 të aktakuzës.

Përgjigja e ZPShK-së ndaj ankesës së avokatit mbrojtës (mendimi i ZPShK-së)

ZPShK-ja me përgjigjen e paraqitur më 30 maj 2013 pohon se ankesa e avokatit mbrojtës *E.P.* është kundërthënëse me vetveten. Prokuroria gjithashtu thekson se dy avokatët mbrojtës kanë bërë parashtrësia kundërthënëse në lidhje me cilësimin juridik të veprës sipas pikës 1 të aktakuzës. Dispozitivi i aktgjykimit të kontestuar është i qartë, faktet janë përshkruar në mënyrë të saktë dhe pjesa e dënimit është e kuptueshme. Nuk ka kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsytimit. Përveç mangësive të kundërshtuara në ankesën e ZPShK-së, aktgjykimi nuk përmban shkeljet e pretenduara nga mbrojtja. Neni 148 i KPPK-së nuk mund të zbatohet për ta cilësuar veprën sipas pikës 1 të aktakuzës pasi që nuk ka pasur vazhdimësi të pandërprerë të përkohshme në mes të veprimeve të palës së dëmtuar dhe gjendjes mendore të ndryshuar të kryerësit, të shkaktuar nga kjo. Një cilësim i tillë juridik do të ishte në kundërshtim me ekspertizën dhe dëshminë e ekspertit të psikiatrisë, dr. *F.D.* i cili ka përshkruar se termi 'afekt mendor' i referohet gjendjes së shkurtër emocionale. Përveç kësaj, ZPShK-ja pohon se nuk është kontestuar nga mbrojtja që vepra është kryer në bashkëkryerje - mënyrë e kryerjes së veprës penale e cila kërkon planifikim dhe bashkëveprim, e cila është në kundërthënie me cilësimin e nenit 148 të KPPK-së. Në lidhje me cilësimin e propozuar juridik të pikës 2 të aktakuzës, ZPShK-ja gjen se argumentet e mbrojtjes janë jo-logjike. Ku në njërin anë avokatët mbrojtës pohojnë se plagosja e *N.R.* ka qenë aksidentale, kurse në anën tjetër ata propozojnë që i pandehurit të shpallet fajtor për veprën penale Lëndime të rënda trupore sipas nenit 154 paragrafit 1 të KPPK-së. Prokuroria propozon që të refuzohet ankesa si e pabazuar.

## Gjetjet e Gjykatës Supreme

### Pranueshmëria e ankesave

Ankesat e ZPShK-së dhe avokatit mbrojtës *E.R.* i në emër të pandehurit janë paraqitur brenda afatit kohor.

Përgjigja në ankesë e avokatit mbrojtës *L.S.* i në emër të pandehurit, edhe pse e titulluar *Përgjigje*, aty jepen propozime të ndara për cilësimet juridike të veprave penale dhe sanksionet për tu shqiptuar. Rrjedhimisht, ajo është më shumë se përgjigje e thjeshtë ndaj ankesës së ZPShK-së. Prandaj, ajo duhet të konsiderohet si ankesë e veçantë në të

drejtën e saj. Pasi që është paraqitur më 5 mars 2013, 14 pas dorëzimit të aktgjykimit të i pandehuri, ajo është paraqitur brenda afatit kohor dhe është e pranueshme.

#### Kompetencat dhe ligji procedural i aplikueshëm

Sipas nenit 545 I KPK-së, pasi që aktakuza është paraqitur nën kodin e vjetër të procedurës, ankesa aktuale është proceduar *mutatis mutandis* sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).

Kolegji është formuar në pajtim me nenin 21 paragrafin 6 të Ligjit mbi Gjykatat (Ligji Nr. 03/L-199, i datës 22 korrik 2010), dhe nenit 3.7 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë ("Ligji mbi kompetencat")

#### Cështjet që duhet adresuar

Cështjet që duhet adresuar nga ky kolegji janë si në vijim: cilësimi juridik i pikave 1 dhe 2 të aktakuzës, përfshirë *mens rea* në lidhje me veprën penale të pikës 2, përcaktimin e dënimit për pikat 1 dhe 2 të aktakuzës, nëse vepra penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 1 të KPPK-së nën pikën 3 të aktakuzës duhet të përfshihet në veprat penale Vrasje dhe Vrasje në tentativë nën pikat 1 dhe 2 apo jo, cili ligj të zbatohet në lidhje me veprën e armëve dhe përcaktimi i dënimit për këto vepra, përcaktimi i dënimit unik, dhe përfundimisht kundërthënia me vetveten apo kundërthënia me dispozitivin apo në mes të dispozitivit dhe arsytimit, siç janë theksuar nga mbrojtja.

#### Cilësimi juridik i veprës sipas pikës 1 të aktakuzës

Avokati mbrojtës *E.R.* në ankesën e tij pretendon se pasi që Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj të kundërshtuar ke gjetur se vepra penale nga pika 1 e aktakuzës është kryer në gjendje të zvogëluar të kapacitetit mendor, ajo është dashur ta dënoj të pandehurin për vrasje të kryer në gjendje të afektit mendor sipas nenit 148 të KPPK-së.

Ky kolegji nuk pajtohet me mbrojtjes por konstaton se përgjegjësia penale është vlerësuar drejtë nga kolegji i mëparshëm në bazë të ekspertizës dhe mendimin e dëshmitarit ekspert të sqaruar gjatë shqyrtimit.

Neni 148 i KPPK-së përcakton:

*Kushdo që tjetrin e privon nga jeta në gjendje të afektit mendor, i vënë pa fajin e tij në gjendje të tronditjes së fortë mendore të shkaktuar nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.*

Është e qartë se neni 148 nuk është i aplikueshëm në këtë situatë. Edhe pse O. Z. e bën përgjegjës H.R. për vdekjen e vëllait të tij, kjo kishte ndodhur shumë vite më parë. Ky provokim nuk mund të përbëjë atë lloj të gjendjes së shokut të rëndë në kohën e të shtënave, siç kërkohet me këtë nen pasi që pasi që nuk ka pasur vazhdimësi të pandërprerë të përkohshme në mes të dy veprimeve. Përveç kësaj, ky kolegji pajtohet me Prokurorinë në mendimin e saj se fakti që akti është kryer në bashkëkryerje tregon së paku për një shkallë planifikimit dhe kontrollit të veprimeve të tyre.

Siç ka gjetur kolegji i mëparshëm, akti do të cilësohet si Vrasje në bashkëkryerje në gjendje të kapaciteti të zvogëluar mendor sipas nenit 146 në lidhje me nenet 23 dhe 12 paragrafin 2 të KPPK-së.

#### Cilësimi juridik i veprës sipas pikës 2 të aktakuzës

Avokati mbrojtës E.R. në ankesën e tij pohon se Gjykata Supreme nuk ka ekzaminuar të gjitha faktet në lidhje me akuzën e pikës 2 të aktakuzës, në veçanti gjykata nuk ka vërtetuar *mens rea*, pasi që pa paramendim për të vrarë, vepra penale Vrasje në tentativë. Ky kolegji nuk pajtohet me mbrojtjen në lidhje me këtë dhe dëshiron t'i referohet paragrafit 36 të aktgjykimit të kundërshtuar:

36. Lidhur me çështjen e dashjes dhe paramendimit, Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se megjithëse O.Z. ka vepruar në gjendje të aftësisë të zvogëluar mendor, nuk ka dyshim se ai me dashje ka shtënë në H.R. dhe N.R. i. Në pajtim me Nenin 15 paragrafin 1 të KPPK-së, një vepër penale mund të kryhet me dashje të drejtë për drejtë apo eventuale. Ligjvënësi përshkruan në Nenin 15 paragrafin 2 dashjen e drejtë për drejtë kur një person, " është i vetëdijshëm për aktin e tij ose të saj dhe dëshiron kryerjen e tij". I pandehuri ishte plotësisht në dijeni të faktit se ai qëlloi dy persona me qëllim vrasjen e tyre. Edhe duke pasur parasysh deklaratën e tij në gjykatë se ai ndjehej i transferuar përsëri në kohën e luftës, ai kishte gatishmërinë për të vrarë kundërshtarët e tij të supozuar me armën e tij duke e ditur se të shtënat prej një distance të shkurtër do të kenë probabilitet të lartë për të shkaktuar vdekjen e personave të sulmuar. Të paktën, ai ka vepruar me dashje eventuale në kuptim të Nenit 15 paragrafit 3

*të KPPK-së, duke qenë i vetëdijshëm se mund të ndodhin pasoja të ndaluara dhe ai është pajtuar për ndodhjen e tyre.....*

Prandaj, është mjaft e qartë se kolegji i mëparshëm i Gjykatës Supreme ka vlerësuar aktin penal siç është akuzuar me pikën 2 të aktakuzës përfshirë të gjitha elementet subjektive të krimit dhe e ka sqaruar atë në arsyetimin e saj.

Ky kolegji plotësisht pajtohet me gjetjet e kolegjit të mëparshëm në lidhje me pikën 2 të aktakuzës dhe se vepra penale patjetër duhet të cilësohet si Vrasje në tentativë sipas nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPPK-së, në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPPK-së dhe në gjendje të kapaciteti të zvogëluar mendor sipas nenit 12 paragrafit 2 të KPPK-së.

Ky kolegji gjithashtu dëshiron të nënvizoj si në vazhdim. Cilësimi juridik i pikës 2 duhet patjetër të bëhet në kontekstin e vlerësimit të pikës 1 të aktakuzës, Vrasje. Nëse dikush në një moment qëllimisht vret një person me revolen e tij dhe pas disa sekondave drejton revolen në personin tjetër dhe qëllon mbi të, aty nuk ka asnjë dyshim se së paku ekziston dashja eventuale për ta vrarë gjithashtu edhe personin e dytë, *dolus eventualis*. Fakti se i pandehuri gjatë kohës së mëparshme është përmbajtur nga sulmimi i <sup>NOR</sup> kur e ka takuar atë, të cilën mbrojtja e ka theksuar gjatë seancës, apo faktin se i pandenuri nuk ka pasur motiv për vrasjen e <sup>NOR</sup> siç ka theksuar avokati mbrojtës <sup>L</sup> <sup>S</sup> në përgjigjen e tij në ankesë, nuk e ndryshojnë këtë konstatim. Prandaj, vepra penale nuk mund të cilësohet si Lëndim i rëndë trupor.

#### Vendimi mbi dënimin për veprat penale sipas pikave 1 dhe 2 të aktakuzës

Sipas nenit 64 të KPPK-së, Gjykata e cakton dënimin për vepër penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë vepër penale. Neni 71 paragrafi 1 i KPPK-së përcakton:

*Nëse kryerësi me një apo me më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpallë dënime për secilën nga këto vepra, e pastaj për të gjitha këto vepra e shqipton dënimin unik.*

Ky kolegji, sikurse edhe kolegji i mëparshëm, ka shpallur <sup>OZ</sup> faktor për Vrasje dhe Vrasje në tentativë në bashkëkryerje në gjendje të kapaciteti të zvogëluar mendor sipas nenit 146, në lidhje me nenet 20, 23 dhe 12 paragrafin 2 të KPPK-së. Ato janë dy vepra penale të ndara. Prandaj, ky kolegji nuk mund të pajtohet me qëndrimin e kolegjit të mëparshëm se veprat nga pikat 1 dhe 2 të aktakuzës mund të dënohen sipas nenit 147 pikës 11 të KPPK-së. Neni 147 pika 11 e KPPK-së nuk mund të interpretohet si rregull thjeshtë për dënim. Ai nuk mund të jetë qëllimi i ligjvënësit. Neni 147 rregullon një krim tjetër, *Vrasjen e rëndë*, e cila siç ka theksuar Prokurori, definon elementet e dënimit për një vepër penale të ndryshme dhe, siç ka nënvizuar avokati mbrojtës <sup>L</sup> <sup>S</sup>, mungon elementi esencial pasi që është kryer vetëm një vrasje. Prandaj,

sipas këtij kolegji do të ishte shkelje kryesisht e dispozitës së nenit 64 paragrafit 1 të KPPK-së që të vendos dënimin sipas nenit 147. Rrjedhimisht, do të shqiptohen dy dënime të ndara për veprat penale të kryera sipas akuzave të pikave 1 dhe 2 të aktakuzës.

Gjatë vendosjes mbi sanksionet penale, ky kolegji ka marrë parasysh peshën e krimeve, sikurse edhe kolegji i mëparshëm, ka marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese që **O**

**Z** i ka pranuar të shtënat dhe posaçërisht faktin se ai ka kryer veprat penale në gjendje të kapaciteti të zvogëluar mendor.

Gjykata Supreme dënon **O.Z.** me tetë (8) vite burgim për Vrasje sipas pikës 1 të aktakuzës, dhe me katër (4) vite burgim për Vrasje në tentativë sipas pikës 2 të aktakuzës.

Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve e kryer më 10 tetor 2005 sipas pikës 3 të aktakuzës

Në aktgjykimin e kundërshtuar, Gjykata Supreme si shkallë e dytë ka konstatuar se shfrytëzimi i armës është përfshirë nën veprat penale Vrasje dhe Vrasje në tentativë. Sidoqoftë, aktakuza kundër **O.Z.** në lidhje me këtë pikë gjithashtu përfshinë elementet tjera të kësaj vepre penale: mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim të paautorizuar të armëve. Vlen të përmendet se i pandehuri në mënyrë të qartë ka pasur armën në posedim para kryerjes së sulmit kundër vëllezërve **R.**

Ky kolegji pajtohet me ZPShK-në se dy veprat penale Vrasja dhe *vepra e armëve* përmbajnë elemente të ndryshme dhe drejtohen kundër vlerave të mbrojtura shoqërore të ndryshme dhe kjo e fundit vetë bart rrezik të konsiderueshëm për shoqërinë dhe duhet të dënohet ndarazi. Pastaj, gjykata do të duhet të aplikonte nenin 374 paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) në fuqi që nga 1 janari 2013, si ligj më i favorshëm për të pandehurin. Duke iu referuar nenit të përmendur, ky kolegji cakton dënimin për veprën e lartpërmendur penale prej një (1) viti dhe gjashtë (6) muajve burgim.

Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve e kryer më 19 prill 2007 sipas pikës 4 të aktakuzës

Siç është përmendur më lartë nën pikën 3, neni i duhur për tu zbatuar për këtë krim është neni 374 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) në fuqi që nga 1 janari 2013, pasi që është ligji më i favorshëm për të pandehurin. Gjatë zbatimit të këtij neni, ky kolegji cakton dënimin për veprën penale nën pikën 4 të aktakuzës prej gjashtë (6) muajve burgim.

Dënimi unik

Gjykata Supreme ka dënuar të pandehurin me tetë (8) vite burgim për pikën 1 të aktakuzës, katër (4) vite burgim për pikën 2, një (1) vit e gjashtë (6) muaj për pikën 3 dhe gjashtë (6) muaj për pikën 4 të aktakuzës. Kolegji shqipton dënimin unik prej dymbëdhjetë (12) viteve burgim sipas nenit 71 të KPPK-së.

Paqëndrueshmëria e brendshme apo kundërthënia me dispozitivin apo në mes të dispozitivit dhe arsytimit

Avokati mbrojtës *E.R.* pohon se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje substanciale sipas nenit 403 paragrafit 1, nën-paragrafit 12 të KPPK-së pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kundërthënës me arsyetimin dhe se i mungojnë faktet vendimtare. Mbrojtja gjithashtu pretendon se dispozitivi është i paqartë pasi që nga i njëjti nuk mund të kuptohet se çfarë vepra ka kryer i pandehuri dhe kundër cilave vepra është shpallur dënimi.

Edhe pse ky kolegji ka ndryshuar aktgjykimin e apeluar deri në një masë të caktuar, nuk mund të pajtohet me mbrojtjen, i cili sipas këtij kolegji, nuk ka theksuar kundërthëniet në mes të dispozitivit dhe arsytimit. Përkundrazi, nuk është gjetur asnjë paqëndrueshmëri apo kundërthënie e brendshme në dispozitiv apo në mes të dispozitivit dhe arsytimit. Siç ka nënvizuar ZPSHK-ja në përgjigjen e saj, dispozitivi është i qartë dhe pjesa e dënimit është e kuptueshme. Prandaj, këto argumente të mbrojtjes refuzohen nga ky kolegji.

Për arsytet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitiv.

**Kryetar i kolegjit:**

**Procesmbajtës:**

\_\_\_\_\_  
Bertil Ahnborg  
Kryetar i kolegjit, Gjyqtar i EULEX-it

\_\_\_\_\_  
Holger Engelmann  
Zyrtar ligjor

**Anëtarët e kolegjit**

---

Nazmije Ibrahim  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

Shukri Sylejmani  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

**Gjykata Supreme e Kosovës**  
**PAII. Nr. 3/2013**  
**Prishtinë**  
**4 shtator 2013**